REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org.
Org.Jedinica
Org Unit 09
Nr.Prot:
Broj Prot:
Prot.No: 05-8087
Nr.i faqeve
Br.stranica
No.pages -30-
Data:
Datum:
Date: 13/11/2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

24 muaj

"Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"

Numri i kontratës[1]: **206-25-4780-2-1-1/C1172**

Nr. i Prokurimit: 206-25-4780-2-1-1

Operatori Ekonomik: **PBC SH.P.K.**

NUI: **810845985**

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
206-25-4780-2-1-1/C1172

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

PBC SH.P.K., Rruga Bekim Fehmiu, 91, Prishtina, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim: **"Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"** me numër identifikues: **206-25-4780-2-1-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Ky aktivitet ka për qëllim të ofrojë një drejtim të qartë dhe të strukturuar për zhvillimin e sistemit të ri informativ me te avansuar se sa ai aktual për Transfuzionin e Gjakut në Republikën e Kosovës**

Nr.	*Grupi*
1	**"Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te përformohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin nga te dyja palët dhe përfundon pas 24 muajsh.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë max. 6 muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: DSISH ne MSH dhe Qendra e Transfuzionin e Gjakut në QKUK.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi Njësi me TVSH	Gjithsejtë (€)
1	**Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ**	Komplet (brenda 12 muajve)	1	€ 54,840.00	€ 54,840.00
	Përshkrimi	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi Njësi për një me muaj me TVSH**	**Gjithsejte për 24 muaj**
2	**Mirëmbajtja mujore e sistemit të QKKTGJ pas zhvillimit**	Muaj	12	€ 1,180.00	€ 14,160.00
				GRAND TOTAL (DDP):	**€ 69,000.00**

Vlera totale indikative e kontratës është **69,000.00** Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është N/A.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Kontrata Publike Kornizë;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
(f) Urdhër blerja;
(g) Sigurimi i ekzekutimit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe[2] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		**Për Ofruesin e Shërbimeve**	
Emri:	**Berat Marmullaku**	***Emri:***	BAJRAM SELMANI
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	***Pozita:***	CEO
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	13.11.2026	***Data:***	13/11/2026
Vula:		***Vula:***	SH.P.K.

[2] Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Shërbimet**" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Sherbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërën nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar,** i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një

inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet; dhe/apo

b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: Caktohet me vendim nga ZKA
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10 % i vlerës totale me vlefshmëri prej 25 muaj
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: (i) Mjetet motorike të Palës së Tretë *[shëno shumen]* (ii) Përgjegjësia e pales së tretë *[shëno shumen]* (iii) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve *[shëno shumen]* (iv) Përgjegjësia profesionale *[shëno shumen]* (v) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve *[shëno* (vi) *shumen]*
Parimet të përgjithshme të pagesave	16	Pagesat të kryhen në bazë të shërbimit (në bazë të pozicioneve të punëve të përfunduara) sipas raportit të certifikimit të kabllove dhe koneksioneve. Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara ne baza mujore (ex post). Nuk ka pagese paraprake.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Menaxheri i kontratës, mbikëqyrësi i menaxherit, Depertamenti i SISH-it, Divizioni i Prokurimit dhe Departamenti Ligjor.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale ne Prishtinë

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Hartimi i specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: Specifikat teknike për dizajnimin, zhvillimin dhe hostimin e Sistemit Informativ të Transfuzionit të Gjakut

Përmbajtja

1. HYRJE 14
2. QËLLIMI I DOKUMENTIT 14
3. ANALIZA E SISTEMIT AKTUAL 15
3.1 Siguria e të dhënave dhe përdorimi i sistemit: 15
4. KËRKESAT TË PËRGJITHSHME 15
5. KËRKESAT FUNKSIONALE DHE JO-FUNKSIONALE: 18
Kërkesat funksionale: Përshkrimi i procesit të punës në Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, QKKTGJ 18
5.1 Dhurimi i Gjakut në Salla 18
5.1.1 Regjistrimi i Dhuruesit të Gjakut 18
5.1.2 Formimi i barkodit për dhuruesit e rinj: 18
5.1.3 Regjistrimi me letërnjoftim dhe të dhëna personale: 18
5.1.4 Të dhënat personale të regjistruara përfshijnë informacione të detajuara si: 18
5.1.5 Kategorizimi i dhuruesve sipas llojit të dhurimit: 18
5.2 Kontrolli Mjekësor i Dhuruesit të Gjakut 19
5.2.1 Matja e parametrave vitalë: 19
5.2.2 Testimi i nivelit të hemoglobinës: 19
5.2.3 Vlerësimi i gjendjes shëndetësore: 19
5.2.4 Pyetësori për historikun mjekësor dhe faktorët e rrezikut: 19
5.2.5 Vendimmarrja mbi Përshtatshmërinë për Dhurim 19
6 PROCESI I DHURIMIT I GJAKUT 19
6.1 Dhurimi i Gjakut 19
6.2 Dhurimi me Aferezë 20
6.3 Kontrolli Mjekësor 20
6.4 Testimet e Dhurimit të Gjakut 20
6.5 Përpunimi dhe Ruajtja e Gjakut 20
6.6 Lëshimi i Gjakut dhe Përbërësve të Gjakut 21
6.7 Testimi i Pacientëve Klinik dhe Ambullantor 21
6.8 Statistikat 21
6.9 Qendrat e Transfuzionit të Gjakut në Rajone 21

6.10 Pajisja e Dhuruesit me Kartelën e Dhurimit 21
7. Kërkesat jo-funksionale: 22
8. NDËRFAQJA ME PËRDORUESIN 23
9. MIGRIMI I TË DHENAVE 23
10. ZHVILLIMI DHE MIRËMBAJTJA: 23
KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË PROFESIONALE .. **ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**
SHKURTESAT ..... **ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**

1. Hyrje

Ministria e Shëndetësisë (MSh) e Republikës së Kosovës është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave shëndetësore në vend, duke përfshirë edhe menaxhimin e shërbimeve jetike si transfuzioni i gjakut. Transfuzioni i gjakut përfaqëson një komponent thelbësor të sistemit shëndetësor, duke siguruar produkte gjaku të sigurta dhe të gjurmueshme për pacientët në nevojë.

Ministria siguron kujdesin shëndetësor për qytetarët, duke krijuar përmes politikave shëndetësore kushte për furnizimin efikas, cilësor dhe të sigurt me gjak dhe përbërës të tij.

1. QKKTGJ-ja, me përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë krijon sistemin informativ për veprimtarinë transfuzive në të gjitha institucionet e autorizuara transfuzive.

2. Regjistri i dhurueseve të gjakut, dhurimeve, rezervave të gjakut dhe përbërësve të gjakut, janë pjesë e sistemit integral i cili mundëson të jetë pjesë e sistemit informativ të veprimtarisë transfuzive.

3.Sistemi i Transfuzionit të Gjakut do të përdoret nga MSH, QKKTGJ në përputhje me kërkesat.

QKKTGJ ushtron veprimtarinë transfuzive në përputhje me Ligjin për Gjakun dhe Përbërësit e Gjakut, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ky ligj. Ky ligj përfshin procedurat e përdorimit, marrjes, testimit, përpunimit, ruajtjes së gjakut dhe furnizimit të qytetarëve dhe pacientëve me gjak dhe përbërësit e tij.

2. Qëllimi i Dokumentit

Ky dokument ka për qëllim të ofrojë një drejtim të qartë dhe të strukturuar për zhvillimin e sistemit të ri informativ me te avansuar se sa ai aktual për Transfuzionin e Gjakut në Republikën e Kosovës. Duke u bazuar në analizën e detajuar të dokumentuar mbi proceset aktuale të punës dhe funksionalitetet e sistemit ekzistues MSTrans, ky dokument identifikon nevojën për transformimin e sistemit nga një platformë desktop në një zgjidhje moderne web, të bazuar në arkitekturë tre-shtresore dhe teknologji bashkëkohore.

Sistemi aktual ka ofruar plotësu bazat e nevojshme për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të dhuruesve të gjakut, gjurmimin e dozave të gjakut dhe mbështetjen e veprimtarive laboratorike, por i mungon fleksibiliteti, shkallëzueshmëria dhe integrimi i nevojshëm me Sistemin Informativ Shëndetësor. Dokumenti paraqet kërkesat teknike dhe funksionale, objektivat e automatizimit, strategjinë e digjitalizimit dhe përshkrimin e moduleve të reja të cilat do të mundësojnë ngritjen e kapaciteteve funksionale dhe operacionale të QKKTGJ dhe qendrave rajonale.

Qëllimi kryesor është krijimi i një platforme të unifikuar, të integruar dhe të përdorshme nga të gjitha institucionet relevante, duke siguruar përputhshmëri me ligjet, rregulloret dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave per dhuruesin dhe dhurimin e gjakut shëndetësore.

3. *Analiza e sistemit aktual*

QKKTGJ ka përdorur Sistemin Informativ Transfuziv (MSTrans) që nga viti 2006. Ky sistem është zhvilluar nga një kompani vendore dhe është krijuar ekskluzivisht për të përmbushur nevojat dhe kërkesat specifike të QKKTGJ-së, duke u bazuar në një analizë të detajuar të punës së brendshme, kërkesave të çdo njësie, si dhe ruajtjes së integritetit dhe sigurisë së të dhënave.

Sistemi është përmirësuar dhe azhuruar vazhdimisht në përputhje me kërkesat e reja të QKKTGJ-së, duke përfshirë hapjen e njësive të reja dhe realizimin e testimeve shtesë. Po ashtu, janë bërë modifikime dhe përmirësime të qëndrueshme në funksionalitetin dhe mbështetje për kërkesat e QKKTGJ-së.

Në këtë kuadër, Sistemi Informativ Transfuziv mundëson lidhjen me Sistemin Informativ Shëndetësor dhe shkëmbimin e kërkesave dhe të dhënave duke pasur parasysh sigurinë e të dhënave per dhuruesin . Megjithatë, kjo lidhje nuk është realizuar ende për shkak të mungesës së Sistemit Informativ Shëndetësor. Funksionalizimi i këtij sistemi dhe lidhja e tij me MSTrans do të mundësonte gjurmimin dhe shtegtimin e gjakut dhe përbërësve të gjakut produkteve të gjakut nga dhuruesi te pacienti, duke siguruar ndjekjen e procesit "vena në venë".

Po ashtu, sistemi ka një version të tij "stand-alone" për përdorim në grumbullimin e gjakut në terren, i cili funksionon offline dhe më pas, pas kthimit në qendër, të dhënat bartën automatikisht në serverin qendror duke pasur parasysh sigurinë e të dhënave per dhuruesin për të parandaluar qasjen e paautorizuar

MSTrans mundëson integrimin e të dhënave nga pajisjet laboratorike dhe është fleksibël për aparaturat që kryejnë analiza në grup (batch). Për këto pajisje, është krijuar një urë që mundëson marrjen e rezultateve direkt nga softueri i aparaturës në sistemin transfuziv në mënyrë automatike.

Një nga funksionalitetet më të rëndësishme të këtij sistemi është mundësia për gjurmimin e secilës dozë të gjakut nga regjistrimi e saj deri në momentin e lëshimit për përdorim klinik. Megjithatë, mungesa e lidhjes me Hospital Management Information System pengon marrjen e informacionit mbi përdorimin e dozave të gjakut në klinika , si dhe regjistrimin e ngjarjeve eventuale të padëshiruara gjatë transfuzionit.

3.1 Siguria e të dhënave dhe përdorimi i sistemit:

Sistemi përdor masa sigurie për të mbrojtur të dhënat. Këto përfshijnë krijimin e përdoruesve me fjalëkalim, caktimin e privilegjeve dhe qasjes sipas detyrave të punës, si dhe regjistrimin e secilit aktivitet të përdoruesve. Ka gjithashtu një ndarje fizike të rrjetit që e bën sistemin të izoluara nga rrjetet e jashtme për të parandaluar qasjen e paautorizuar.

Sistemi ruan të dhënat për periudha të përcaktuara nga me ligji dhe siguron mundësinë e nxjerrjes dhe analizës së tyre, duke mundësuar prodhimin e raporteve të gjeneralizuara, personalizuara dhe kryqëzuara sipas nevojës.

4. Kërkesat të përgjithshme

Të gjitha vendimet që lidhen me zhvillimin e sistemit të avanacuar të Transfuzionit të Gjakut dhe gjatë periudhës së implementimit duhet të merren në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) në formë të shkruar. Zbatimi i çdo vendimi të marrë do të jetë subjekt i miratimit nga MSh.

Sistemi i Transfuzionit të Gjakut do të hostohet në servera të menaxhuar dhe administruar nga MSh. duke pasur parasysh sigurinë e të dhënave.

Sistemi i Transfuzionit të Gjakut do të avancohet nga Windows Desktop Aplikacion- në aplikacion ueb me një arkitekturë me tre shtresa në platformën ASP.NET Core dhe me bazën e të dhënave në

Microsoft SQL Server 2022 dhe teknologjitë mbështetëse për funksionimin e duhur të të gjitha komponentëve të sistemit.

Pasi të plotësohen kërkesat, operatori ekonomik duhet të bëjë një prezantim para ekipit të projektit dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme, kur është e nevojshme. Pas çdo faze të zhvillimit, operatori ekonomik do të raportojë me shkrim te menaxheri i projektit dhe kërkon miratimin paraprak për punën e kryer.

Sistemi i Transfuzionit të Gjakut duhet të jetë integruar dhe të mund të lidhet me aplikacione dhe sisteme të tjera të ngjashme, ose ku të dhënat e sistemit mund të shërbejnë si hyrje ose dalje për sisteme të tjera dhe anasjelltas. duke pasur parasysh sigurinë e të dhënave.

Operatori ekonomik duhet të ketë parasysh që duhet të përgjigjet për çdo kërkesë të paraqitur nga MSh dhe që lidhen me projektin si një tërësi.

Pas përfundimit dhe implementimit të sistemit në QKKTGJ, Qendrat Rajonale dhe SHSKUK dhe pas skadimit të periudhës së mirembajtjes(1vjeqare) – OE duhet te dorezoj materialet si ne vijim:

- Manualin e përdorimit të Sistemit të Transfuzionit të Gjakut
- Detajet teknike (instalimi, konfigurimi) dhe manualin e administrates
- Materialin e trajnimit të përdorur gjatë trajnimit të stafit
- Kodet e algoritmeve të përdorura për enkriptim dhe dekryptim
- Kodet burimore.

Sistemi i Transfuzionit të Gjakut do të jetë në tri gjuhë (Shqip, Anglisht dhe Serbisht) dhe do të mundësojë mundësinë e shtimit të një gjuhe tjetër. Versioni në gjuhën shqipe do të jetë by default.

Operatori ekonomik duhet të analizojë procesin e punës dhe të marrë parasysh të gjitha kërkesat ligjore dhe teknike që burojnë nga MSh dhe QKKTGJ. Çdo zhvillim duhet të respektojë ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret, procedurat përkatëse të punës dhe kërkesat e MSh, ndërsa në aspektin teknik ne presim zgjidhjen më të mirë nga operatori ekonomik.

OE duhet të ketë parasysh se gjatë fazës së analizës dhe zhvillimit mund të paraqiten mënyra të reja për dizajnimin ose përbërjen e moduleve apo pjesëve specifike të Sistemit të Transfuzionit të Gjakut. Prandaj, ajo ka detyrimin t'i zbatojë këto ndryshime në përputhje me nevojat e identifikuara. Sistemi i Transfuzionit të Gjakut duhet të mundësojë që personat e autorizuar të kenë akses në ne baze te privilegjeve te perdoruesve dhe të kenë mundësi të kufizuara për të parë, ndryshuar dhe futur të dhëna vetëm sipas autorizimeve të tyre.

Operatori ekonomik do të mundësojë përmes shërbimeve web dërgimin dhe marrjen e të dhënave nga bazat e të dhënave të tjera që lidhen me këtë sistem dhe t'i automatizojë ato, kur është e mundur, ose madje të krijojë forma të tjera për regjistrimin e këtyre të dhënave, në përputhje me kërkesën e MSh me ane te API -ve.

Sistemi i Transfuzionit të Gjakut duhet të jetë i aftë të përballojë një fluks të madh përdoruesish dhe shërbimesh në të njëjtën kohë, pa kompromentuar efektivitetin dhe efikasitetin e tyre. Për këtë qëllim, është e domosdoshme të sigurohet një indeksim i mirë i të dhënavebimeve që ofron në të njëjtën kohë, pa humbur efektivitetin dhe efikasitetin e këtyre shërbimeve, për të cilin duhet të mundësohet një indekshim i mirë i të dhënave.

Sistemi i Transfuzionit të Gjakut duhet të jetë kompatibël me të gjitha shfletuesit e internetit në të gjitha pajisjet dhe responsive pasi qe te te perdure edhe ne pajisje mobilje.

Koha e intervenimit

OE duhet të sigurojë ndërhyrje të shpejtë për çdo problem të raportuar. Duhet të përshkruhet koha e reagimit dhe mekanizmi për ndërhyrje në raste emergjente.

- Prioritet 1 – jo me vone se 20 minuta pas lajmrimit nga AK gjate gjithë kohës se mirëmbajtjes 24/7
- Prioritet 2 – Jo me vone se 2 dite pune për krijimin e raporteve te reja
- Prioritet 3 – jo me vone se 5 dite pune riparimet dhe ndryshimet ne kërkesat funksionale tesistemit
- Prioritet 4 – avancimi i moduleve te reja jo me vone se 20 dite pune.Operatori ekonomik do të mundësojë integrimin në Sistemin e Transfuzionit të Gjakut të çdo shërbimi ueb ose forme tjetër të caktuar për kërkimin dhe shfaqjen e të dhënave përkatëse sipas nevojës nga MSh duke pasur parasysh sigurinë e të dhënave per dhuruesin

Teknologjia që do të përdoret gjatë dizajnit dhe zhvillimit të aplikacionit do të mbështetet nga platformat që përdoren në institucionet e Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik do të jetë i detyruar të dorëzojë te MSh, në të dyja formatet, të shtypura dhe elektronike, (kompletuar) kodet burimore, si dhe të gjitha algoritmet për enkriptim dhe validim, dokumentacionin, procedurat, manualet dhe materialet e tjera të lidhura me Sistemin e Transfuzionit të Gjakut, në përputhje me kërkesën.

Pronari i Sistemit të Transfuzionit të Gjakut do të jetë MSh, pasi të drejtat e autorit për sistemin si një tërësi dhe për kodet burimore do ti takojnë MSh. Gjithashtu, operatori ekonomik do të jetë i detyruar të vendosë sistemin në mjedisin real me kodin burimor, në mënyrë që çdo herë versioni më i fundit aktiv të jetë.

MSh do të ruajë të drejtat e plota për të instaluar dhe rinstaluar Sistemin e Transfuzionit të Gjakut, kur të konsiderohet e nevojshme, dhe për të bërë ndryshime brenda kodit burimor kur të jetë e nevojshme.

Operatori ekonomik duhet të ketë parasysh që MSh ruan të drejtën për të shtuar ose ndryshuar fusha dhe pjesë të Sistemit të Transfuzionit të Gjakut gjatë periudhës së kontratës.

Siguria e Sistemit të Transfuzionit të Gjakut është përcaktuar për të garantuar mbrojtjen e të dhënave, integritetin e proceseve dhe sigurinë e përgjithshme të sistemit gjatë funksionimit të tij:

• Niveli i aplikacionit

1. Lidhja me Sistemin e Transfuzionit të Gjakut për nivelin e administratorit ose role të tjera të definuara nga MSh, do të bëhet përmes përdoruesit, fjalëkalimit përkatës dhe CAPTCHA.

2. Fjalëkalimi ruhet në bazën e të dhënave në formë të enkriptuar dhe të pakthyeshme (hash fjalëkalimi i kriptuar - SHA1).

• Niveli i bazës së të dhënave

1. Lidhja me bazën e të dhënave të Sistemit të Transfuzionit të Gjakut realizohet përmes një mekanizmi të sigurt autentikimi, duke përdorur metoda të përshtatshme të qasjes si SQL Authentication ose autentikim të integruar.

2. Sistemi i Transfuzionit të Gjakut do të përdorë shtresën SSL për të siguruar një komunikim të sigurt. Operatori ekonomik është i obliguar të implementojë certifikatën SSL të ofruar nga Ministria e Shëndetësisë.

Sistemi i Transfuzionit të Gjakut duhet të mundësojë ndarjen e përdoruesve në grupe të ndryshme, si dhe menaxhimin e të drejtave të tyre në nivele të ndryshme të sistemit, në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Shëndetësisë. Menaxhimi i të drejtave do të realizohet në këto nivele:

- Në nivel moduli
- Në nivel forme apo raporti

- Në nivel regjistri
- Në nivel të një pjese të caktuar të sistemit

Në këtë mënyrë, sistemi siguron fleksibilitet dhe kontroll të detajuar të aksesit për secilin përdorues.

5. ***Kërkesat funksionale dhe jo-funksionale:***

Kërkesat funksionale: Përshkrimi i procesit të punës në Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, QKKTGJ

Procesi operacional në Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGJ) është i standardizuar dhe i strukturuar sipas praktikave më të mira, duke mbuluar të gjithë ciklin e menaxhimit të dhurimit të gjakut. Sistemi përfshin fazat e identifikimit dhe regjistrimit të dhuruesve, kontrollin mjekësor paraprak, testimin dhe verifikimin e cilësisë së gjakut, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e komponentëve të gjakut. Ky zinxhir operacional siguron gjurmueshmëri të plotë dhe garanton furnizim të qëndrueshëm, të sigurt dhe cilësor me gjak për pacientët në nevojë.

5.1 Dhurimi i Gjakut në Salla

5.1.1 Regjistrimi i Dhuruesit të Gjakut

Regjistrimi i dhuruesve është hapi i parë në proces dhe përmban disa hapa të rëndësishëm për të siguruar një menaxhim të saktë dhe të sigurt të dhuruesve.

5.1.2 Formimi i barkodit për dhuruesit e rinj:

Sistemi krijon një barkod unik për secilin dhurues të ri, i cili ndihmon në gjurmimin e dhurimeve të ardhshme dhe lidhjen e tyre me profilin personal të dhuruesit në bazën e të dhënave. Ky proces siguron që çdo dhurues të identifikohet në mënyrë unike dhe të shmangen gabimet e mundshme të regjistrimit.

5.1.3 Regjistrimi me letërnjoftim dhe të dhëna personale:

Identifikimi bëhet me dokument zyrtar (letërnjoftim ose pasaportë) për të verifikuar identitetin e dhuruesit.

5.1.4 Të dhënat personale të regjistruara përfshijnë informacione të detajuara si:

Emrin, mbiemrin, datëlindjen, adresën e banimit, të cilat ndihmojnë në gjurmimin e dhuruesve dhe njoftimin e tyre për dhurime të ardhshme.

Kontaktet personale (numri i telefonit, email-i) për të lehtësuar komunikimin me dhuruesin në raste të nevojshme.

Grupin e gjakut dhe historikun e dhurimeve, të cilat janë të rëndësishme për përshtatshmërinë e dhuruesit me marrësit potencialë të gjakut.

Gjendjen shëndetësore dhe ndonjë medikament që mund të ndikojë në dhurim, për të siguruar se dhuruesi është i përshtatshëm për dhurim pa rreziqe për veten ose marrësin.

5.1.5 Kategorizimi i dhuruesve sipas llojit të dhurimit:

Dhurues vullnetar – dhurojnë pa një përfitim personal dhe janë burimi më i rëndësishëm i furnizimit me gjak.

Dhurues familjar – dhurojnë për të afërm të tyre ose persona të njohur që kanë nevojë urgjente për gjak.

Dhurues aferez – japin vetëm një komponent specifik të gjakut, si plazmën ose trombocitet, përmes një procedure të veçantë që lejon kthimin e pjesës tjetër të gjakut në trupin e dhuruesit.

Dhurues për herë të parë – individë që dhurojnë për herë të parë dhe për të cilët krijohet një profil i ri në sistem.

Dhurues i shumëfishtë – persona që kanë dhuruar më shumë se një herë dhe konsiderohen si dhurues të rregullt, të cilët ndihmojnë në sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm të gjakut.

5.2 Kontrolli Mjekësor i Dhuruesit të Gjakut

Ky hap është thelbësor për të siguruar që dhuruesi është në gjendje të mirë shëndetësore dhe se procesi i dhurimit nuk do të ketë ndikime negative në shëndetin e tij ose të marrësit të gjakut. Përfshin:

5.2.1 Matja e parametrave vitalë:

Tensioni i gjakut, pulsi dhe temperatura trupore maten për të siguruar që dhuruesi është në gjendje të përshtatshme për dhurim.

5.2.2 Testimi i nivelit të hemoglobinës:

Një test i shpejtë përcakton nivelin e hemoglobinës për të siguruar që dhuruesi nuk vuan nga anemi dhe është i aftë për dhurim.

5.2.3 Vlerësimi i gjendjes shëndetësore:

Identifikimi i shenjave të lodhjes, infeksioneve ose problemeve të tjera shëndetësore që mund të ndikojnë në dhurimin e gjakut.

5.2.4 Pyetësori për historikun mjekësor dhe faktorët e rrezikut:

Përfshin pyetje mbi sëmundjet e kaluara, përdorimin e medikamenteve, ndërhyrjet kirurgjikale të fundit dhe faktorët e mundshëm të rrezikut për sëmundje infektive.

5.2.5 Vendimmarrja mbi Përshtatshmërinë për Dhurim

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga ekzaminimi mjekësor, vendoset:
Aprovimi për dhurim nëse dhuruesi i plotëson kriteret e përshtatshmërisë.
Shtyrje e përkohshme nëse dhuruesi ka ndonjë gjendje të përkohshme që e bën të papërshtatshëm për dhurim.
Përjashtim i përhershëm nëse dhuruesi ka ndonjë sëmundje të rëndë ose faktor rreziku që e bën të papërshtatshëm përgjithmonë për dhurim.

6 Procesi i dhurimit i Gjakut

- Regjistrimi i dhurimit dhe numri i sistemit të qeses së gjakut, etiketimi i mostrave te gjakut (barkod)

6.1 Dhurimi i Gjakut

1. **Regjistrimi i Dhuruesit të Gjakut**
   - Po ashtu si në sallë, regjistrimi i dhuruesve në teren duke siguruar të dhënat personale dhe grupin gjakut
2. **Kontrolli Mjekësor i Dhuruesit të Gjakut**
   - Vlerësimi i shëndetit të dhuruesit nga mjeku transfuziolog

3. **Dhurimi i Gjakut**
    - Regjistrimi i dhurimit dhe numri i sistemit të qeses së gjakut etiketimi i mostrave te gjakut
4. **Dhurimi i Gjakut në Teren**
    - Sistemi duhet të jete ne gjendje të ruaj edhe të dhena offline pasi të regjistrohen të dhënat në terren.

6.2 Dhurimi me Aferezë

1. **Regjistrimi i Dhuruesit të Gjakut**
    - Regjistrimi i dhuruesve për aferezë me të dhënat e kërkuara
2. **Kontrolli Mjekësor i Dhuruesit të Gjakut**
    - Vlerësimi nga mjeku transfuziolog për të siguruar përshtatshmërinë për dhurim
3. **Dhurimi i Gjakut**
    - Regjistrimi i dhurimit dhe numri i sistemit të qeses së gjakut, etiketimi i mostrave te gjakut

6.3 Kontrolli Mjekësor

1. **Të Dhënat Shëndetësore të Domosdoshme për Dhurim**
    - Regjistrimi i të dhënave shëndetësore të dhuruesve për vlerësim dhe shqyrtim të mundësive të dhurimit
2. **Arsyet e Refuzimit**
    - Shpjegimi dhe regjistrimi i arsyeve të mundshme për refuzimin e dhuruesve

6.4 Testimet e Dhurimit të Gjakut

1. **Testimi Imunohematologjik**
    - ABO, Rh dhe skrining për antitrupa të parregullt
2. **Testimi për Sëmundjet Transmisive**
    - Hepatiti B (HBs-Ag), Hepatiti C (Anti-HCV), HIV1/2 (Anti-HIV 1/2), Sifilisi
3. **Testimi Molekular për Sëmundjet Transmisive**
    - HBV, HCV, HIV

6.5 Përpunimi dhe Ruajtja e Gjakut

1. **Gjaku i Plotë**
    - Përpunimi dhe ruajtja e gjakut të plotë për përdorim të mëvonshëm (krijimi i barcodit të ri)
2. **Eritrocite të Koncentruara**
    - Eritrocite të filtruar, të larë, të ndara me Reveos
3. **Plazma e Freskët e Ngrirë (PFN)**
    - Plazma e ndarë me aferezë dhe me Reveos
4. **PPT - Plazma e Pasur me Trombocite**
    - Përgatitja dhe ruajtja e plazmës me trombocite
5. **Pull Plazëm**
    - Dëshira për përdorim të dozave të plazmës (1-3 doza)

6. **Trombocit i Koncentruar**
    - Trombocite të fituara nga afereza, Reveos ose dhurues i rastit (1-10 doza)
7. **Krioprecipitat**
    - Përgatitja dhe ruajtja e krioprecipitatit (1-10 doza)
8. **Kollapsi**
    - Procedurat për trajtimin e kolapsit të gjakut

6.6 Lëshimi i Gjakut dhe Përbërësve të Gjakut

1. **Regjistrimi i Kërkesës për Gjak**
    - Regjistrimi i kërkesave nga klinikat për transfuzion
2. **Grupi ABO dhe Rh**
    - Verifikimi i grupit të gjakut dhe përputhshmërisë
3. **Përzgjedhja e Qeses së Gjakut dhe Interaksioni**
    - Përzgjedhja e qeses së duhur dhe kontrolli për përputhshmërinë e reagimeve
4. **Lëshimi i Gjakut, Vërtetimi dhe Çregjistrimi i Qesës së Gjakut**
    - Lëshimi i produkteve të gjakut dhe regjistrimi përfundimtar

6.7 Testimi i Pacientëve Klinik dhe Ambullantor

1. **Testimi Imunohematologjik**
    - Kontrolli i grupit të gjakut dhe përshtatshmërisë për transfuzion
2. **Testimi Prenatal**
    - Testimi për shtatzënat dhe nevojat e mundshme të transfuzionit
3. **Testimi i Hemostazës**
    - Vlerësimi për gjendjen e koagulimit të gjakut

6.8 Statistikat

- Zhvilli i dashboard sipas nivelit duke shfaqur gjendjen në kohën reale
- Gjenerimi dhe analiza e statistikave mbi dhurimin e gjakut dhe përdorimin e tij gjenerimi i raporteve dinamike sipas kërkesave

6.9 Qendrat e Transfuzionit të Gjakut në Rajone

- Rrjeti i Qendrave të Transfuzionit të Gjakut në rajon dhe menaxhimi i tyre

6.10 Pajisja e Dhuruesit me Kartelën e Dhurimit

- Dhënia e kartelës së dhuruesit për çdo individ që merr pjesë në procesin e dhurimit

Operatori ekonomik është i obliguar të kryejë një analizë të detajuar funksionale të të gjitha proceseve të punës që do të mbulohen nga sistemi, duke u bazuar në dokumentacionin ekzistues të ofruar nga autoriteti kontraktues. Kjo analizë duhet të identifikojë në mënyrë të qartë pikat kyçe dhe specifikat funksionale të secilit proces, duke pasur parasysh se shumë prej tyre kërkojnë trajtim dhe zbatim të veçantë.

Sistemi web që do të zhvillohet duhet të përfaqësojë një përmirësim të dukshëm funksional dhe teknologjik në krahasim me sistemin aktual, duke:

- Reflektuar kërkesat e reja të përcaktuara nga autoriteti kontraktues;

- Adresuar nevojat reale të përdoruesve institucionalë;
- Ofruar fleksibilitet, shkallëzueshmëri dhe efikasitet në operim;
- Siguruar përputhshmëri të plotë me standardet dhe praktikat më të mira të zhvillimit të sistemeve shëndetësore.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të gjitha komponentët funksionalë të sistemit të jenë të integruar në mënyrë të qëndrueshme dhe të mbështesin ciklin e plotë të punës në përputhje me objektivat e përcaktuara nga autoriteti kontraktues.

7. Kërkesat jo-funksionale:

Kërkesat jo- funksionale për Sistemine Transfuzionit të Gjakut, të strukturuara me parametra të matshëm për vlerësim dhe zbatim praktik. Tabela në vijim përfaqëson një version të vlerave.

Kategoria	Indikatori/Parametri	Vlera
Performanca	Koha e përgjigjes për kërkesat më të zakonshme (CRUD)	≤ 800 ms për 90% të operacioneve
	Koha për kërkesat kritike (kërkimi i qeseve të gjakut)	≤ 500 ms në 95% të rasteve
	Gjenerimi i raporteve të avancuara	≤ 2.5 sekonda për 95% të raporteve
	Kapaciteti i përdoruesve aktivë	≥ 500 përdorues njëkohësisht
	Analiza laboratorike në batch	≥ 8,000 analiza/orë
Siguria	Fjalëkalime me kriptim të fortë	SHA-256 ose bcrypt
	Login me MFA	≥ 99% hyrje me verifikim të dytë (opsionale)
	Auditim i akseseve	100% e aktiviteteve
Disponueshmëria	Kohë operimi (uptime)	≥ 99.9% në vit
	Rikuperimi nga dështimi (RTO)	≤ 60 minuta
	Humbja maksimale e të dhënave (RPO)	≤ 15 minuta
Shkallëzueshmëria	Zgjerim modular	Mbështetje horizontale
	Rritja vjetore e të dhënave	≥ 30% pa degradim performance
Ndërveprimi	Sisteme të integruara, krijimi I API	≥ disa sisteme (SMSN, laboratorë, klinika, etj)
Përdorshmëria	Koha për trajnim të stafit të ri	≤ 90 minuta
	Kënaqësia e përdoruesve	≥ 90% përdorues të kënaqur
	Përkrahja e pajisjeve/shfletuesve	PC, Laptop, Tablet /Chrome, Firefox, Edge, Safari + Responsive

8. Ndërfaqja me përdoruesin

Duhet të sigurohet një ndërfaqe e thjeshtë dhe miqësore për përdoruesit, përfshirë një dizajn të qartë dhe të lehtë për tu naviguar.

Trajnimi dhe mbështetja për përdoruesit për ta mësuar sistemin e ri dhe për ta përdorur në mënyrë efikase.

OE duhet të përgatisë Video manulin, udhëzuesin në tri gjuhë profesionale.

Trajnimi i stafit do të realizohet për të gjithë përdoruesit e sistemit sipas organizimit të QKKTGJK dhe OE për të gjitha ISH në cilat do të përdoret.

9. Migrimi i të dhenave

Migrimi i të dhënave nga sistemi aktual (MSTrans) në sistemin e ri web për Transfuzionin e Gjakut përbën një komponent thelbësor për vazhdimësinë e funksionimit institucional dhe integritetin e informacionit shëndetësor. Operatorit ekonomik i kërkohet të analizojë në detaje strukturën e bazës ekzistuese të të dhënave dhe të përgatisë një plan të plotë për migrim, duke përfshirë fazat e ekstraktimit, transformimit, pastrimit, validimit dhe ngarkimit të të dhënave. Procesi duhet të sigurojë që të gjitha të dhënat kritike—përfshirë informacionin e dhuruesve, dhurimet e kaluara, rezultatet laboratorike, kërkesat e spitaleve dhe shpërndarjet e produkteve të gjakut—të transferohen me saktësi dhe pa humbje apo korruptim të të dhënave.

Migrimi duhet të realizohet në mënyrë graduale dhe të testuar, duke filluar me një fazë pilot në një mjedis të kontrolluar dhe duke përfunduar me një migrim përfundimtar përpara aktivizimit të sistemit të ri. Duhet të garantohet që raportet, statistikat dhe historiku i dhurimeve të jenë të disponueshme në mënyrë të pandërprerë edhe për të dhënat e migruara, në mënyrë që të ruhet qasja në informacionin ekzistues dhe të mundësohet analiza retrospektive.

Operatorit i kërkohet të dorëzojë dokumentacion të detajuar për të gjitha skriptet dhe procedurat e përdorura gjatë migrimit, përfshirë loget e kontrollit dhe verifikimit të të dhënave. Ky dokumentacion do të përdoret nga autoriteti kontraktues për të vlerësuar saktësinë dhe suksesin e migrimit dhe për të siguruar që sistemi i ri është funksional dhe i besueshëm nga

dita e parë e përdorim

10. Zhvillimi dhe mirëmbajtja:

Operatori Ekonomik (OE) është i obliguar të analizojë në mënyrë të detajuar dhe të zhvillojë sistemin e ri digjital, duke u bazuar plotësisht në funksionalitetet dhe kërkesat e sistemit ekzistues (sistemit paraprak). Çdo funksionalitet i secilit modul duhet të analizohet dhe zhvillohet në çdo detaj, në përputhje me proceset aktuale të punës dhe kërkesat e institucioneve përkatëse.

Për këtë qëllim, do të zhvillohen module të veçanta për secilën njësi funksionale — si laboratori, afereza dhe njësi të tjera përkatëse — të cilat do të jenë të ndara, të dedikuara dhe të ndërtuara sipas specifikave të dala nga analiza dhe sistemi paraprak.

Sistemi duhet të jetë i zhvilluar në platformë web-based, duke garantuar qasje të sigurt dhe të kontrolluar për QKKTGJ dhe të gjitha qendrat rajonale të transfuzionit të gjakut. Kjo do të mundësojë përdorim të lehtë, qasje të centralizuar dhe shkëmbim të të dhënave në kohë reale ndërmjet njësive të ndryshme.

OE propozon planin e zhvillimit te aplikacionit dhe fazen e implementimit në periudhë (6) mujore si dhe mirembajtjen dhe mirëmbajtjen 12 muaj pas dorëzimit të aplikacionit.

Çdo kërkesë që del nga analiza, si dhe çdo funksionalitet i identifikuar si i domosdoshëm për vazhdimësinë e punës, duhet të implementohet pa asnjë kosto shtesë.

OE duhet të dorëzoj Metodologjinë e propozuar dhe planin e punës.

Shkurtesa	**Emërtimi i Plotë**
MSh	Ministria e Shëndetësisë
QKKTGJ	Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut
SHSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
OE	Operatori Ekonomik
API	Application Programming Interface
MSTrans	(emërtim vendor i sistemit ekzistues)
SSL	Secure Sockets Layer
SHA-1 / SHA-256	Secure Hash Algorithm
PPT	Plazma e Pasur me Trombocite
PFN	Plazma e Freskët e Ngrirë
CRUD	Create, Read, Update, Delete
CAPTCHA	Completely Automated Public Turing test to tell Computers and Humans Apart
RTO	Recovery Time Objective
RPO	Recovery Point Objective
PMP	Project Management Professional
SMSN	Sistemi Mbikqyrjes Sëmundjeve Ngjitëse

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi Njësi me TVSH	Gjithsejtë (€)
1	**Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ**	Komplet (brenda 12 muajve)	1	€ 54,840.00	€ 54,840.00
	Përshkrimi	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi Njësi për një me muaj me TVSH**	**Gjithsejte për 24 muaj**
2	**Mirëmbajtja mujore e sistemit të QKKTGJ pas zhvillimit**	Muaj	12	€ 1,180.00	€ 14,160.00
				GRAND TOTAL (DDP):	**€ 69,000.00**

Identifikim i operatorit ekonomik (oe)	
Emri i oe:	**PBC Sh.P.K.**
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit te oe:	**Bashkim Selmani**
Nënshkrimi:	
data:	**18.07.2025**
vula:	

Prokurimi: 206-25-4780-2-1-1

Nr i brendshëm:

Tituli: "Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"

1	**"Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"**

Kodi i tenderit: 206-25-4780-2-1-1

Data: 18.07.2025

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	Oferta_QKKTGJ_1_.pdf
2.	Oferta_QKKTGJ_2_.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	"Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"	Cmimi.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

AUTORITETI KONTRAKTUES

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ZAGREBIT , P.N., -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 206-25-4780-2-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **PBC SH.P.K., Rruga Bekim Fehmiu, 91, 10000, Prishtina, Kosovë**

E-mail: **bs@pbc.group**

Personi kontaktues: **Bashkim Selmani**

Telefoni: **044 467 467**

Faxi:

Numri fiskal: **810845985**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 206-25-4780-2-1-1

Titulli i kontratës: "Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 "Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ"

3. Çmimi total i tenderit është:

69,000.00 EUR

Dhe në fjalë [*shëno çmimin e tenderit në fjalë* ***Euro****]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqësit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

SCARDIAN
SIGURIME

0081268

NUMRI I POLICËS	081268
SIGURUESI	K.S. SCARDIAN J.S.C Adresa: Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine, Kosovo
AGJENTI	SCARDIAN HQ Adresa: Rr. Perandori Justinjan Nr. 69
I SIGURUARI	PBC SH.P.K Adresa: RR IDRIZ GJILANI P.N.
NUMRI I BIZNESIT	810845985
NUMRI FISKAL	601211890
QËLLIMI I SIGURIMIT	Garanci e Kontratës
PËRFITUESI	MINISTRIA E SHëNDETëSISë
TITULLI I KONTRATËS	ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I SISTEMIT INFORMATIV Të QKKTGJ
NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT	206-25-4780-2-1-1
TERRITORI I MBULIMIT	Republika e Kosovës
PERIUDHA E SIGURIMIT	761 ditë
SHUMA E SIGURUAR	6,900.00 EURO
Nga:	13-11-2026
Deri:	13-12-2028
PRIMI I SIGURIMIT	258.75
TVSH 18 %	46.58
PRIMI +TVSH 18%	305.33
DATA E LËSHIMIT	2026-11-12 15:29:12

VËREJTJE: NUMRI I KONTRATëS : 206-25-4780-2-1-1/C1172

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës.Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruari/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruari/ përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI	SCARDIAN
(emri, mbiemri, nënshkrimi)	(emri, mbiemri, nënshkrimi)

KOMPANIA E SIGURIMEVE SCARDIAN JSC SCARDIAN ZQ

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE SIGURIMIT TË GARANCIVE

Neni 1
Scardian Sigurime (Siguruesi) ka lëshuar për të Siguruarin (debitori kryesor) me kërkesën e këtij të fundit, çertifikatën e garancisë dhe policën e sigurimit, në mbulim të përgjegjësisë së saj (brenda periudhës/vlefshmërisë të sigurimit), ndaj "Përfituesit" (autoriteti kontraktor) deri në shumën/vlerën e siguruar.

Neni 2
I Siguruari (debitori kryesor) dhe Përfaqësuesi i tij (debitori solidar) pranon përmbajtjen e Çertifikatës së Garancisë dhe Policës së Sigurimit, dhe detyrohet të paguaj primin përkatës të sigurimit si dhe të përdorë Çertifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit për qëllimin e mirë për të cilat ato lëshohen, duke ju përmbajtur moralisht dhe ligjërisht të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre.

Neni 3
Objekti i Çertifikatës së Garancisë dhe Policës së Sigurimit është sigurimi i detyrimit që mund të lind në të ardhmen nga konfiskimi i Garancisë që Siguruesi ka lëshuar për të Siguruarin (debitori kryesor) dhe në favor të Personave të tretë, siç dhe përcaktohet në Çertifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit, brenda periudhës/vlefshmërisë të sigurimit.

Neni 4
Scardian Sigurime ka të drejtën e rimbursimit nga Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar të çdo shume brenda vlerës totale të siguruar, plus interesa, kamat vonesa apo çdo shpenzim për ribursimin e çdo shume që Siguruesi bëhet përgjegjës të paguaj, në përputhje me detyrimet e parashikuara në Çertifikatën e Garancisë dhe Policës së Sigurimit.

Neni 5
Në rast se Përfituesi (autoriteti kontraktor) i përcaktuar në Çertifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit, paraqet kërkesë për "konfiskimin e garancisë", Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës do t'i paguajnë Siguruesit, ose do të vendosin si kesh kolateral (para) në emër të tij, çdo shumë që Siguruesi bëhet përgjegjës të paguajë sipas përcaktimit në nenin 3 (tre) dhe 4 (katër) të kësaj kontrate, pavarësisht nëse Siguruesi, ka kryer apo jo pagesë sipas detyrimeve të parashikuara në Çertifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit.

Neni 6
Kërkesa e Përfituesit (autoriteti kontraktor) për "konfiskimin e garancisë" do të jetë e vlefshme kur shoqërohet nga;

(a) Çeritifikata e Garancisë dhe Polica e Sigurimit;
(b) Kopja e vendimit të Gjykatës, nëse ka të tillë;
(c) Njoftimin/komunikimin paraprak (me shkrim) me Deb
itorin Kryesor, në lidhje me moskryerjen e detyrimeve nga ana e tij dhe anullimin e marrëdhënies kontraktuale;
(d) Dokumentacionin e plotë (prova), që vërteton mosplotësimin e detyrimeve nga Debitori Kryesor;

Neni 7
Siguruesi do të shtyjë kohën e pagesës, për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e Përfituesit për të marrë pagesën, ose/dhe nëse janë filluar hetime penale në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Përfituesit, Debitorit Kryesor dhe/ose Debitori Solidar, ose/dhe për aq kohë sa i Përfituesi nuk paraqet dhe plotëson dokumentacion e kërkuar nga Siguruesi.
Barra e shpenzimeve për sigurimin e provave, që vërtetojne humbjen dhe mosplotësimin e detyrimeve nga Debitori Kryesor, bie mbi Përfituesin.

Neni 8
Scardian Sigurime i lind e drejta që t'i drejtohet Debitorit Kryesor dhe/ose Debitorit Solidar, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e të gjitha shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfituesit/Autoritetit Kontraktor (cedimi i të drejtave nga Përfituesi tek Siguruesi).

Neni 9
Të gjitha detyrimet e çfarëdo natyre që Siguruesi duhet të përballojë për kthimin e shumës së garancisë së paguar, janë në ngarkim të Debitorit Kryesor dhe/ose Debitorit Solidar.

Neni 10
I Siguruari (debitori kryesor) dhe "Përfituesi" (autoriteti kontraktor) njoftojnë Siguruesin në rast të ndryshimeve eventuale të kontratës midis tyre. Në këtë rast Çertifikata e Garancisë dhe Polica e Sigurimit konsiderohet e zgjidhur dhe Siguruesi çlirohet nga detyrimi për të dëmshpërblyer.

Neni 11
Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar bien dakort që në rast kërkese nga Siguruesi do të mundësojnë vendosjen e barrave siguruese mbi pasuri të luajtëshme dhe/ose barreve hipotekore mbi pasuri të paluajtëshme pronë të tyre (kontrata mbi hipotekën e lidhur midis palëve kontraktuese).

Neni 12
Kjo Kontratë do të konsiderohet pjesë integrale e Çertifikatës së Garancisë dhe e Policës së Sigurimit.

Neni 13
Kjo Kontratë, në kuptim të përmbushjes së detyrimeve nga palët kontraktuese, përbën titull ekzekutiv në bazë të Ligjit mbi Marredheniet e Detyrimeve. Në rast se Debitori Kryesor dhe/ose Debitori Solidar nuk respekton detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë, Siguruesi në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ka të drejtë t'i drejtohet menjëherë Gjykatës Ekonomike të Prishtinës, për lëshimin e Urdhër Ekzekutimit të kësaj Kontrate.

Neni 14
Çertifikata e Garancisë është e vlefshme vetëm kur është e shoqëruar me Policën e Sigurimit të Garancisë, mbi bazën e të cilës ajo është lëshuar.

Neni 15
I Siguruari (debitori kryesor) dhe Përfaqësuesi i tij (debitori solidar) janë të detyruar t'i dorëzojnë "Përfituesit" (autoriteti kontraktor) Çertifikatën e Garancisë së bashku me Policën e Sigurimit. Në rast se "Përfituesi" (autoriteti kontraktor), brenda 7 (shtatë) ditëve, nga data e lëshimit, nuk i kundërshton Çertifikatën e Garancisë dhe Policën e Sigurimit, atëherë nga Siguruesi do të konsiderohen si të pranuara nga Përfituesi (autoriteti kontraktor) dhe nuk mund të kundërshtohen më prej tij.
Nëse Debitori Kryesor apo/dhe Debitori Solidar, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e mësipërme, Siguruesi çlirohet nga përmbushja e detyrimeve të tij

Neni 16
Për çfarë nuk është përcaktuar shprehimisht në këtë Kontratë do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Neni 17
Në rast se ndonjë apo më shumë nga dispozitat e kësaj Kontrate dhe akteve të tjera të cilave kjo Kontratë i referohet shpallen apo mund të konsiderohen të pavlefshme, të paligjshme apo të pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave që mbeten nuk do të ndikohet. Palët në mirëbesim do të negociojnë për të zëvendësuar dipozitat e kontestueshme me dipozita të vlefshme me efekte riparuese të përafërta me qëllimin e palëve të shprehur sipas kësaj Kontrate.

Neni 18
Ndryshime eventuale të kësaj Kontrate mund të bëhen me Aneks-Kontratë, të nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 19
Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve si rezultat i kësaj Kontrate zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt do të jenë kompetencë e Gjykatës Ekonomike të Prishtinës.

Neni 20
I Siguruari (debitori kryesor) dhe Përfaqësuesi i tij (debitori solidar) deklarojnë me përgjegjësi të plotë ligjore se në rast të mospërmbushjes së obligimeve nga ana e tyre ndaj Përfituesit (autoriteti kontraktor), dhe kërkesës të këtij të fundit për "konfiskimin e garancisë", atëherë Scardian Sigurime, ka autorizim të plotëfuqishëm, për të bërë rimbursimin e plotë të çdo shumë që bëhen përgjegjës të paguajë, nga "llogaria bankare" e Debitorit Kryesor apo Debitorit Solidar.

Neni 21
Qëllimi ynë është që ta bëjmë punën drejtë që nga fillimi dhe gjithmonë. Në rast se ne bëjmë ndonjë gabim, ne do të mundohemi që ta rregullojmë shumë shpejt. Ne do tju konfirmojmë gjithmonë pranimin e ankesës brenda pesë ditëve të punës dhe do ta bëjmë më të mirën tonë që ta zgjidhim problemin brenda katër javëve. Në rast se ne nuk mundemi, do tju njoftojmë kur mund të pritet përgjigjja.

Në rast se ju keni ankesë ju lutemi të kontaktoni në:

Kompania e Sigurimeve SCARDIAN J.S.C.
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Numri i telefonit: 00381 38 777 444
Fax: 00381 38 777 444
Email: scardianankesa@scardian.com

Pjesë përbërëse e policës: 081268

Për: MINISTRIA E SHëNDETëSISë
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: PBC SH.P.K, RR IDRIZ GJILANI P.N.
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE: NUMRI I KONTRATëS : 206-25-4780-2-1-1/C1172

Titulli i aktivitetit të prokurimit: ZHVILLIMI DHE AVANCIMI I SISTEMIT INFORMATIV Të QKKTGJ
Numri i prokurimit: 206-25-4780-2-1-1

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t`i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **6,900.00 EURO (GJASHTE MIJE E ENENEQIND EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **6,900.00 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen 781 ditë
Data e fillimit: 13-11-2026

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

KOMPANIA E SIGURIMEVE SCARDIAN JSC SCARDIAN

SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2026-11-12 15:29:12